



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë**  
**Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 (a) nga Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Unionit Evropian për rregullat e bashkëpunimit në aspekt të ndihmës financiare nga KE për Republikën e Maqedonisë dhe zbatimin e ndihmës sipas komponentës V (IPARD) të Instrumentit për ndihmë para-hyrëse ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 165/2008) dhe në bazë të Programës për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë para-hyrëse për bujqësi dhe zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 83/2009 dhe 96/2013),

**Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural**

më 08 korrik të vitit 2013 shpall

**THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2013**  
për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve  
nga IPARD programa 2007-2013

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (në tekstin e mëposhtëm: Agjencioni) si institucion kompetent dhe organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë para-hyrëse për bujqësi dhe zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) i fton të gjithë interesuarit persona fizik dhe juridik nga Republika e Maqedonisë të dorëzojnë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 për masat në vijim:

**Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritje të standardeve të Unionit Evropian**

**Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit Evropian**

**Masa 302 – Diverzifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale**

1. Përkrahja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë prej 75% mjete të siguruara nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD), në përputhshmëri me Marrëveshjen financiare shumvjeçare 2007-2011 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.
2. **Mjete financiare për kërkesë individuale** jepen si përkrahje financiare e pakthyeshme (grant) në shumë prej 50% nga vlera e harxhimeve të pranueshme, gjegjësisht 55% për kërkesë të dorëzuar nga bartësi i ekonomisë bujqësore jo më i moshuar se 40 vjet në ditën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve për masën 101.
3. **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 22 gusht të vitit 2013.**
4. **Tërheqja e formularëve dhe udhëzuesve:**





Formularët e nevojshëm për “Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programa 2007-2013” si dhe “Udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programa 2007-2013” në të cilët janë të përmbajtur të gjitha informatat për kriteriumet, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushtet për finansim dhe informatat tjera të cilët janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013, Udhëzues për përgatitjen e Planit Afarist, Udhëzues për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet kompetente dhe informacione të tjera të dobishme në verzionin elektronik mund të meren nga ueb-adresa e Agjencionit: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e shtypura prej kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 si dhe udhëzuesin për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programa 2007-2013 mund të meren drejtpërdrejt në Agjencion në adresën:

**Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural  
bul. 3 - ta Makedonska Brigada nr 20. (ndërtesa Makedonija Tabak, bloku C), 1000 Shkup**

dhe në qendrat më të afërta rajonale të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej orës 8:30 deri më 16:30. (Lista qendrave rajonale apo njësive punuese të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhëna për kontakt është e shpallur në ueb-adresën [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)).

#### **5. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:**

Kërkuesi duhet të plotëson dhe të dorëzon Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 për masë individuale, Plan Afarist të përgatitur sipas Udhëzuesit për përgatitjen e Planit Afarist dhe dokumentacionit të shoqëruar siç është e cekur në Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013. Informata më detaje për kërkesat specifike për pranueshmëri janë të specifikuar në Udhëzuesin për shfrytëzuesit e mjeteve na IPARD Programa 2007-2013.

Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 dhe Plani Afarist përpunohen në gjuhën maqedone.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013 së bashku me Planin Afarist dhe dokumentacionin e përgjithshëm të nevojshëm dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të epërm “MOS E HAP” për Thirrjen Publike 01/2013 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në recepcionin e Agjencionit.

#### **Vërejtje:**

Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve nga IPARD Programa 2007-2013, Plani Afarist dhe dokumentacioni i dorëzuar NUK KTHEHEN. Për kryerjen e kontrollës në teren nga ana e Agjencionit duhet që kërkuesi të ketë në vetvete kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuara deri te Agjencioni

Informata më detale në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb-faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

